


Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit: Komuna Suharekë OE ankues: “Flamuri 1979”	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 215/19
Prej:	 Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 215/19 të parashtruar nga OE “Flamuri 1979” - Suharekë		
Datë	31.05.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 16.05.2019, me nr. 215/19 të parashtruar nga OE “Flamuri 1979” - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”**, me numër të prokurimit: **624-19-314-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Suharekë**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA SUHAREKË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – FLAMURI 1979.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Flamuri 1979” - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”**, me numër të prokurimit: **624-19-314-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Suharekë**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	21.05.2019	31.05.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 16.05.2019, OE “Flamuri 1979&Dreni-A” - Suharekë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Xoni&Osmani” - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”**, me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “Flamuri 1979” - Suharekë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “Flamuri 1979” - Suharekë, janë:

- Neni 10 - Mjetet për promovimin e transparencës;
- Neni 57 - Sigurimi i Tenderit;
- Neni 59 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Neni 69 - Aftësia teknike dhe / ose profesionale;
- Neni 39 - RrUOPP-se.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Flamuri 1979” - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”**, me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.

Neni 69 i LPP-s

Neni 10 i LPP-s

Neni 57 i LPP-s

Neni 39 i Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit Neni 41. i Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit Neni 4. i Rregullave për tenderët jo nornealisht të ulët

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të tenderit duke mos i marrë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë ka bërë shkelje të këtij neni për shkak se nuk e ka bërë një vlerësim të drejtë. Në dispozitat e nenit 59 paragrafi 4 shprehimisht është paraparë se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në Seksionin II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) nenin 7.1 & 7.2 është paraparë kërkesa 1.Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje) dhe si dëshmi është kërkuar 1. Çertifikata e regjistrimit të biznesit, së bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje), nga e cila rezulton se asnjëri nga anëtarët e grupit nuk e kanë veprimtarinë e aktivitetit të biznesit 5210-Magazinimi dhe Ruajtja, ndërsa në specifika teknike dhe përshkrimin e çmimit si paramasë është paraparë Deponimi i automjeteve. Pra duke mos e pasur në aktivitet të biznesit këtë pikë grupi i O.E. nuk e ka plotësuar këtë kërkesë dhe Autoriteti Kontraktues e ka marrë si të përgjegjshëm këtë grup edhe pse nuk i ka plotësuar kërkesat.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në Seksionin II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) nenin 9.1 & 9.2 është paraparë kërkesa si vijon: 1.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar projekte të ngjashme në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerën prej së paku 60.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese të këtyre projekteve. Si dëshmi për realizimin me sukses është kërkuar: 1.Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbali et e pranimit teknik.

Gjatë vlerësimit të tenderit në fjalë, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se grupi i O.E. "XONI" SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" i kanë plotësuar të gjitha kërkesat dhe kanë vendosur që të njejtin ta shpërblejnë me kontratë, mirëpo në bazë të

dokumentacionit të cilin e ka ofruar grupi i O.E. fitues rezulton se ky grup nuk e ka plotësuar kërkesën e lartëcekur për arësye se grupi në tërësi ka ofruar dëshmi se ka përfunduar kontratë me autoritete publike në vlerë prej 17,171 00 € ndër të cilat ka transport të masës drusore e që nuk është e ngjashme me objektin e kontratës në fjalë. Si dëshmi grupi ka ofruar referencat përkatëse mirëpo të njejtat nuk e plotësojnë kërkesën minimale e cila ka qenë 60,000.00 €. Grupi i O.E. në listën e projekteve ka paraqitur kontrata fiktive të cilat i ka paraqitur me qëllim të vënies në lajthim të komisionit të vlerësimit dhe si dëshi ka ofruar referencat fiktive andaj duke mos kërkuar sqarim në lidhje me këto referenca konsiderojmë që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-s.

Nga protokollin e bashkëpunimit në mes të "Sigma" Viena Insurance Group dhe anëtarit të Grupit N.SH. "Osmani" të paraqitur nga ky i fundit shihet se është manipuluar me këtë dokument duke paraqitur informacione jo të vërteta përkatësishtë mashtruese me qëllim të vënies në lajthim të komisionit, pasi që në protokollin në fjalë shkruan se N.SH. "Osmani" do të riparoj mjetet e aksidentuara, ndërsa referenca i është lëshuar si dëshmi për transportin e automjeteve për riparim.

Autoriteti Kontraktues duke pasur parasysh se Grupi i O.E. "XONI" SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" kanë ofruar informacione të pa vërteta apo mashtruese është dashur që këtij grupi t'ia konfiskoj sigurimin e tenderit duke u bazuar në nenin 57 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-s

Në nenin 69 të LPP-s shprehimisht është paraparë që: 4.2 (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

Grupi i O.E. O.E. "XONI" SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" nuk ka ofruar dëshmi që ka siguruar shërbimet sikur i ka paraqitur në listën e projekteve por vetëm ka dorëzuar dokumente fiktive si kontrata të pa noterizuara dhe referenca fiktive nga firma me të cilat ka lidhje familjare apo marrëdhënie tjera shoqëpore. Pra Autoriteti Kontraktues duke i marrë për bazë këto referenca fiktive pa kurrëfarë dëshmie si faturë, raport bankar apo dokument tjetër që evidenton se ka përfunduar një kontratë e tillë e shpërblen me kontratë grupin e O.E. në fjalë dhe duke vlerësuar në këtë mënyrë konsiderojmë që ka bërë shkelje edhe të nenit 69 të LPP-s.

Në nenin 39 të Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit në paraqitjen tabelare shprehimisht është paraparë që nëse lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerësimit se përcaktuar duhet të refuzohet tenderi pa kërkuar informacion të mëtejshëm andaj me qenë se Grupi i O.E. "XONI" SH.P.K. & N.SH. "OSMANI" nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, është dashur që t'ia refuzoj tenderin grupit në fjalë për shkak se nuk e ka mbërri vlerën minimale të kontratave të realizuara. Pra duke pasur parasysh atë që u cek më lartë konsiderojmë që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe të dispozitave të këtij neni.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe të nenit 41. të Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit duke e neglizhuar vlerësimin e këtij tenderi. Hapja e tenderit është bërë me 05.03.2019 ndërsa vendimi i Autoritetit Kontraktues është bërë me dt. 30.04.2019 pra si pasoj e neglizhencës vlerësimi është vonuar 51 ditë ndërsa në bazë të dispozitave të nenit në fjalë është dashur që të vlerësohet tenderi brenda afatit prej 30 ditëve nga data e hapjes së tenderit dhe në veqanti nëse natyra e prokurimit në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në vecanti për kontratat e një natyre

komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Autoriteti Kontraktues i ka kaluar të gjitha afatet e parapara edhe pse kjo procedure nuk mund të quhet procedurë komplekse sepse të gjitha kushtet dhe kriteret kanë qenë të parapara, gjithashtu edhe specifikat kanë qenë të qarta pra nuk ka vend që kjo procedure të konsiderohet komplekse, por edhe po të qëndronte një gjë e tillë Autoritetit Kontraktues duhet të na kishte njoftuar me shkrim në lidhje me këtë qështje andaj konsiderojmë që ka bërë shkelje edhe të këtij neni.

Pasi kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit në fjalë kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarim nga Grupi i O.E. "XONI" SH.P.K. & N.SH. "OSMANT" në lidhje me tenderin jo normalisht të ulët:

Në nenin 4. të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët në paragrafin 4.4. është paraparë dispozita si në vijim:

Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

4.4.1 ekonominë e procesit të prodhinatarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

4.4.2 Çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 7

4.4.3 Çfarëdo kushte vecanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, Sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

4.4.4 -Originalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Nga përgjigjia e Grupit të O.E. "XONI" SH.P.K. & N.SH. "OSMANT" vërehet se nuk ka kurrëfarë baze me të cilën do ta realizon Kontratën në fjalë për arësyse se çmimi i tenderit të tyre është shumë i ulët në krahasim me objektin e kontratës dhe se nuk ka kurrëfarë baze për të marrë në konsideratë pikat e lartëcekura të kërkuara për tenderët jo normalisht të ulët. Andaj një sqarim qesharak nga O.E. është dashur që të refuzohet sepse çmimi i dhënë nuk i mbulon shpenzimet e karburantit e lëre më shpenzimet tjera të amortizimit, pagesën e punëtorëve etj. pasi që arësyetimi i tyre se venddeponimin e kanë 1.7 km nga qendra e qytetit dhe shpenzimet për një transport nuk e tejkalojnë shmën prej 1.2 Euro nuk janë as për së afërmi realitetit pasi që territori i Komunës së Suharekës përfshinë fshatra dhe shtrihet në një hapësirë prej 361 km² andaj nuk duhet llogaritur vetëm hapësirën prej qendrës deri tek deponimi për zhvendosje të automjeteve, por duhet pasur parasysh nëse një aksident ndodh psh. në fshatrat Maqitev, Budakovë, Dolloc etj. ku distanca nga qyteti është së paku 16 km dhe shpenzimet vetëm të karburantit e kapin vlerën e përafërt prej 20 litra naftë. Autoriteti Kontraktues në sqarimin e tyre ka cekur se vendi i kryerjes së shërbimeve është Komuna e Suharekës, e që nënkupton se këto shërbime do të kryhen në tërë territorin e komunës, ndërsa arëyetimin e grupit të O.E. fitues e ka marrë si të mjaftueshëm edhe pse e ka cekur vetëm distancën nga qendra deri te deponimi i zhvendosjes së automjeteve.

Andaj duke e pranuar një arësyetim të tillë nga O.E. Autoriteti Kontraktues është dashur që të bazohet në dispozitat e nenit 4 pika 4.6.2 nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit

abnormalisht të ulët”, brenda dy dite nga data e vendimit.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues me pranimin e një oferte abnormalisht të ulët ka dëmtuar edhe buxhetin e vetë sepse në specifika teknike është paraparë që për qdo bartje O.E. ti paguaj 5 % të vlerës së faturës.

Nga Autoriteti Kontraktues kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik, mirëpo nuk na janë ofruar disa dokumente me arësyetimin se dhënia e dokumenteve si Raporti i vlerësimit të tenderit përbën shkelje të LPP-s andaj konsiderojmë se është bërë edhe shkelja e nenit 10 të LPP-s

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, **kërkojmë** nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta detyroj Autoritetin Kontraktues që automatikisht ta pezulloj procedurën e prokurimit në fjalë, duke u bazuar në faktet e paraqitura më lartë të aprovoj këkesën tone si të bazuar, vendimin për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rivlerësim me detyrimin e Autoritetit Kontraktues që të evitoj shkeljet e procedurës gjatë vlerësimit të tenderit dhe të na shpërblej me kontratë neve si O.E. i vetëm i përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Me shkeljet e lartëcekura do të na shkaktohen dëme të konsiderueshme sepse janë bërë shpenzime për përgaditjen e ofertës tonë, shpenzime të kësaj ankeses si dhe fitimin e humbur në rastë se do të shpërbleheshim me kontratën në fjalë. Dëme do të shkaktohen edhe vetë Autoritetit Kontraktues sepse ka paraparë fitimin prej 5% të vlerës së faturës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përfundim me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përfundim me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....	11.02.2019
Lloji i procedurës së aplikuar.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....	Kontratë publike kornizë, Shërbim
Vlera e parashikuar e kontratës.....	46,445.00€
Kriteri për dhënie të kontratës.....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	05.03.2019
Data e hapjes së ofertave.....	05.03.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	26.04.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm.....	30.04.2019
Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës.....	26.04.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	06.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	07.06.2019

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1) Deklarata nën betim , qe tenderuesi i plotëson kërkesat mbi përshtatshmërinë ne pajtim me Ligjin Nr04L-042 2) Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe te tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet te jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri ne datën e hapjes se ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës 3) Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësorë te lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe nuk duhet te jete me i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri ne ditën e dhënies.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1).Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes) 2).Vërtetimi i ATK (i verifikuar ne web faqen e ATK-se). 3).Vërtetimi nga gjykata kompetente (Original ose kopje e noterizuar nga noteri) Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj dhe te vazhdoj me shpërbllim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Flamuri 1979" - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës", me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Suharekë.

1.Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit (kopje) 2.Çertifikata e Numrit Fiskal, nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit (kopje) 3.Çertifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK (kopje).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Çertifikata e regjistrimit të biznesit, se bashku me dokumentin Informatë mbi Bizneset (kopje). 2. Çertifikata e numrit Fiskal nëse nuk është e përfshirë në certifikatën e biznesit (kopje). 3.Çertifikata per Regjistrim në TVSH (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë është jo më pak se 90.0000,00 euro.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik, në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë është jo më pak se 90.0000,00 euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Dokument nga banka për qarkullimin e OE ose pasqyrat e auditura financiare, ose deklaratat vjetore tatimore të dorëzuara në ATK.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuar projekte të ngjashme në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerën prej së paku 60.000,00 euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit DHE dëshmi për përfundimin me suksese të këtyre projekteve. 2. Kualifikimet (të drejtën për vozitje) të personelit të operatorit ekonomik, në veçanti të shoferëve, për realizimin e projektit. Stafit prej së paku tre (3), duhet të ketë kategorinë C të vozitjes. 3. Pajisjet në Emër të OE me të cilat do të kryhen Shërbimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është -Tri (3) Automjete transporti për bartjen e veturave. -Një (1) Automjet transporti për bartjen e evturave që duhet të posedojë edhe kranin kapsen për vetura. 4.Me qëllim që deponimi i vetuave të bëhet në vendë të sigurt, OE duhet të ketë në dispozicion hapësirë të mjaftueshme, së paku 2500 m2 (25 ari), e cila duhet të jetë e rrethuar dhe nën vëzhgim të kamerave.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara në tre vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, DHE dëshmitë e përfundimit Referenca t ose procesverbali et e pranimit teknik. 2.Kontrata ose mareveshja me shoferë, ID e secilit shofer dhe kopjen e patent shoferit. 3.Librezat kopje të pajisjeve ose kontratat faturat e blerjes së pajisjeve apo marëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve. Në rastet kur OE ofron kontrata fatura te blerjes se pajisjeve apo mareveshjeve per shfrytezimin e tyre, pajisjet duhet te deshmoohen me kopjen e librezave. Po ashtu nga nje foto te cecilit automjet per qellime verifikimi. 4.Fleta pozeduese e hapesires, nese nuk eshte ne pronesi te OE, mareveshja per shfrytezim apo me qera, foto te hapësirës ku shihen rrethojat dhe kamerat.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi/€	Vërejtje
1.	"Xoni&Osmani"	Suharekë	2.55€	JO

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Flanuri 1979" - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës", me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Suharekë.

2.	“Flamuri&Dreni-A”	Suharekë	24.55€	JO
3.	“TCK”	Suharekë	61.00€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Mehmet Lezi – Kryetar i komisionit
- Fisnik Tahiri – Anëtar i komisionit
- Ragip Berisha – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

1). OE TCK, është i papërgjegjshëm sepse OE ne formular ka vendosur çmimin e pa papeshuar kjo ka bere qe nga formulari dhe ne hapje te këtë difference me shume se 2 % dhe nuk e i ka plotësuar kërkesat lidhur me kapacitetin mbi gjendjen ekonomike dhe financiare.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	Xoni&Osmani	Suharekë	2.55€
2.	Flamuri&Dreni-A	Suharekë	24.55€

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se OE ofertues “Xoni&Osmani” është i përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë, me çmim prej: 2.55€. Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Flamuri 1979” - Suharekë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues “Flamuri 1979”, është njoftuar nga AK-Komuna Suharekës si tenderues i pasuksesshëm dhe ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontratë.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues, i cili pretendon se OE i rekomanduar për kontratë duhet te shpallet i papërgjegjshëm me arsyetimin se i njëjtë ne informatorin e certifikatës se biznesit nuk e ka veprimtarin adekuate – 5210, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit nuk ka kërkuar qe operatori ekonomik te këtë te regjistruar veprimtarin adekuate te natyrës se këtij aktiviteti te prokurimit. Prandaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues, qe ka te beje me kontratat dhe referencat e OE te rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se kontrata me titull: Riparimi i automjeteve te dëmtuara, kontratë e nënshkruar me datën: 28.01.2014, dhe ne nenin 11 te kësaj kontratë thuhet se kontrata lidhet ne kohëzgjatje te pacaktuar. Ndërsa ne referencën e dorëzuar për këtë kontratë thuhet se “Menaxhmenti i kompanisë Sigma për vitin 2016, 2017 dhe 2018 lëshon referencën me titull: Transporti i automjeteve te

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Flamuri 1979” - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Suharekës”, me numër të prokurimit: 624-19-314-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Suharekë.

dëmtuara për riparim”.

Eksperti shqyrtues, sa i përket këtij pretendimi, vlerëson se kjo kontratë ka kundërthënie për fakti se siç u sqarua edhe me lart ne kontratë thuhet: Riparimi i automjeteve te dëmtuara dhe nuk përmendet transporti i automjeteve, ndërsa ne referencë përmendet vetëm transporti i automjeteve. Prandaj ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se nuk është dashur te vlerësohet pa u sqaruar sipas nenit 72 te LPP-se.

Poashtu eksperti vlerëson si te qëndrueshëm pretendimin e OE ankues sa i përket kontratës me titull: Transporti i masës drusore, për faktin nuk ka te beje me natyre e këtij aktiviteti te prokurimit.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar listën e kontratave dhe referencave te OE te rekomanduar për kontratë fillimisht sqaron se ne total i rekomanduari për kontratë ka ofruar listën e kontratave dhe referencave ne vlere prej: 102,146.00 euro.

Përfundimisht eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me lart për dy kontratat dhe vlerën totale te ofruar nga i rekomanduari për kontratë, sqaron se kur zbritet vlere e dy kontratave te lartpërmendura rezulton se totali është 65,451.00 euro, qe do te thotë vlere është brenda kërkesës se AK-se te kërkuar ne dosje te tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Pretendimi tjetër i OE ankues ne lidhje me kontratat dhe referencat ka te beje atë se sipas OE ankues ka dorëzuar kontrata fiktive me te cilët ka lidhje familjare apo marrëdhënie tjera shoqërore, konkretisht kontrata me operator privat.

Eksperti shqyrtues, sa i përket këtij pretendimi vlerëson se është i paqëndrueshëm për faktin se ne dosje te tenderit nuk është kërkuar qe për kontratat me operator ekonomik privat te dëshmohen me dëshmi tjera shtese dhe njëherit sqaroj se sipas nenit 56.3 te LPP-se nuk mund te eliminohet një operator ekonomik për një kërkesë apo dëshmi e cila nuk është e vendosur paraprakisht ne dosje te tenderit.

Prandaj, eksperti shqyrtues ne fund vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kërkesën e AK-se, për kontrata dhe referenca, duke u bazuar ne vlerën përfundimtare prej: 65,451.00 euro.

Lidhur me pretendimin e OE ankues për shkelje te nenit 41 te RRUOPP-se, për shkelje te afateve ligjore qe kanë te bëjnë me afatin e vlerësimit te ofertave, eksperti shqyrtues e vlerëson si te paqëndrueshëm për faktin se përveç 50 ditëve qe parashihen ne nenin e lartpërmendur, ne te njëjtin nen parashihen edhe deri ne 5 dite pasa hapjes se ofertave, fillimi i punës se komisionit te vlerësimit.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues për çmimin e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, për te cilin pretendon se ka ofruar çmim Jo/ Normalisht te ulet. Eksperti shqyrtues vlerëson se sipas paragrafit 3 te nenit 61 te LPP-se, është e drejte e AK-se, qe marrjes se informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë dhe njëherit lidhur me nenin 61 te LPP-se, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja i ka respektuar procedurat e nenit te lartpërmendur, për çmimin e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa vendimi për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.